



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 72 Akti

Nr. 78 Vendimi

Tiranë, më 15. 11.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Olsi Komiçi	Anëtar
Xhensila Pine	Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, më datë 13 nëntor 2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Alma Liçaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Znj. Alma Liçaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Subjekt i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, u shortuar më datë 15 janar 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj, relatore.

Më datë 15.01.2018, znj. Alma Faskaj, ka paraqitur dorëheqjen për arsye të konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit nga kjo çështje. Kjo dorëheqje u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, i caktuar me short, i cili pas shqyrtimit të parashtrimeve të komisioneres Alma Faskaj, më datë 29.01.2018, vendosi të pranojë dorëheqjen e saj.

Anëtari zëvendësues Xhensila Pine, i shortuar në të njëjtën ditë nga trupi gjykues, më datë 15.01.2018, zëvendësoi relatoren e dorëhequr, znj. Alma Faskaj, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Liçaj.

Pas zëvendësimit të relatorit, trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Lulzim Hamitaj dhe Xhensila Pine relatore, me vendimin nr. 1, datë 31.01.2018, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe të caktojë me mirëkuptim kryesues të trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në konflikt interesi.

U administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ("ILDKPKI") sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ("DSIK") sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë ("KLD"), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

Më datë 22.10.2018, trupi gjykues nr. 4, me vendimin nr. 2, vendosi:

- Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këtë kriter, bazuar në nenin 52, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi rezultatet e hetimit, bazuar në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, si dhe të drejtën për të marrë një kopje të tyre, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtën për të kërkuar marrjen e provave dhe dhënien e shpjegimeve si dhe thirrjen e dëshmitareve, brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit.

Trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, më datë 24.10.2018, me *e-mail*, për vendimin sa më sipër.

Më datë 01.11.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e saj së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

Më datë 08.11.2018, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, më datë 13.11.2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë.

Më datë 13.11.2018, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj.

Në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, znj. Alma Liçaj, i paraqiti trupit gjykues kërkesën për përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, për të si subjekt rivlerësimi.

Trupi gjykues vendosi, të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dhe të përfundojë çështjen vetëm për kriterin e pasurisë, pasi bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 për këtë kriter, provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë, dhe për arsye se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura para Komisionit, në përgjigje të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën për sa i ngarkohej në kalim të barrës së provës.

Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast, gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

PROCESI I VLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË NGA ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka bërë vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i pasaktë;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

RIVLERËSIMI PËR KRITERIN E PASURISË NGA KOMISIONI

Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, kreu hetimin e tij të pavarur¹ në vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje pasurie, deklarim të rremë. Nga hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, ka rezultuar:

1. Pasuria, apartament banimi, me sip. 107.08 m², 2+1, k. (*) + vendparkim nr. (***), ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë.**

Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, ka deklaruar: Pasurisë, apartament banimi, me sip.107.08 m² dhe vendparkim, Rr. “(***)”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 12.12.2009, të lidhur me shoqërinë “(***)” sh.p.k + shoqërinë “(***)” sh.p.k.

¹ “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioneri Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut V2 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

1.1.1. Si burim krijimi në deklaratën “Vetting”, deklarohet: Kontrata e huas, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 20.10.2008, lidhur me shtetasin A. M., për vlerën 60,000 euro; Hua në shumën 12,000 euro marrë vëllait të bashkëshortit të subjektit, z. A. L., më datë 02.12. 2009. Diferenca e shumës së vlerës së apartamentit me vlerën e huave të marra në shumën 25,664 euro është likuiduar si përfitim i uljes së vlerës nga shoqëria si pasojë e mbylljes së llogarive me shoqërinë ndërtuese.

Vlera: 97,664 euro. Pjesa takuese: 50 %

1.2 Në deklaratën periodike të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit deklaron si burim krijimi për këtë apartament: 1) zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes të vitit 2008; 2) Paga; 3) Kursime.

Vlera: 97,664 euro. Pjesa: 100 %

1.3 Në deklaratën periodike të vitit 2016 subjekti i rivlerësimit deklaron: “*diferenca e mbetur pa shlyer në vlerën 25,664 euro është përfiturar ulje nga kompania sipas marrëveshjes së palëve bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punime të kryera vetë dhe penalitete për shkak të vonesave në dorëzimin e objekteve*”.

1.4. Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 20.12.2010, pranë ILDKPKI-së, sjellë si provë nga subjekti i rivlerësimit dhe administruar nga Komisioni, subjekti është pyetur për diferencën prej 25,664 eurosh e cila nuk është deklaruar, znj. Alma Liçaj, është përgjigjur se “*nuk e ka pasur të qartë në momentin e plotësimit të deklaratës*”.

1.4.1 Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 15.09.2014, pranë ILDKPKI-së sjellë si provë nga subjekti i rivlerësimit dhe administruar nga Komisioni, znj. Alma Liçaj, është pyetur, a e ka marrë në dorëzim apartamentin dhe a është likuiduar kësti i fundit i tij? Në përgjigje ajo ka deklaruar, në vitin 2014 për apartamentin janë dorëzuar çelësat e tij dhe është në pritje të regjistrimit dhe hipotekimit nga firma ndërtuese. Gjithashtu ajo ka deklaruar se nuk është likuiduar vlera e këstit të fundit të apartamentit pasi kjo shlyerje do të bëhet kur apartamenti të regjistrohet dhe hipotekohet.

1.5 Nga analizimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së rezultoi se nuk është deklaruar duke filluar nga deklarata periodike e vitit 2009, vendparkim i subjektit.

1.6 Nga analiza financiare bërë për subjektin e rivlerësimit për vitin 2009, rezultoi se:

Përshkrimi	2009
Të ardhurat	1,319,246
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,319,246
Shpenzime	1,350,868
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683,036
Shpenzime për shlyerje huaje shtetasit A. M.	650,000
Shpenzime udhëtimi	17,832
Pasuri	2,234,267
Apartament banimi 2+1, me sip.107.08 m ² , shlyer 72,000 euro	9,876,240
Autoveturë, tip “Mercedes-Benz”, VL (***)	600,000
Prishja e kontratës së porosisë së vitit 2008	8,230,200
Ndryshim likuiditeti (gjendje në fund - gjendje në fillim) ²	11,773
Të ardhura - shpenzime – pasuri	- 2,265,889

² Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit vjen si rezultat i ndryshimit të gjendjes së llogarive bankare të subjektit dhe personave të lidhur në fillim të vitit dhe në fund të vitit 2009.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektivit të rivlerësimit për mospërputhje midis deklaratës “Vetting” dhe deklaramit periodik të 2009.

- *Për sa i përket pjesës takuese. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, deklaruar si pjesë takuese 50 %, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2009, deklaruar pjesë takuese 100 % bashkëshorti i subjektivit.*
- *Për sa i përket burimit të krijimit. Në deklaratën “Vetting” deklaruar si burim krijimi: kontratë huaje me shtetasin A. M. për vlerën 60,000 euro; hua në shumën 12,000 euro marrë shtetasit A. L. dhe diferenca e shumës së apartamentit përfituar si ulje likuiduar shoqërisë ndërtuese, në deklaratën periodike të vitit 2009, deklaruar si burim krijimi zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes; paga dhe kursime.*
- *Nuk ka deklarim nga deklarata periodike e vitit 2009, të vendparkimit me nr. 8. Nga analiza financiare për vitin 2009, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme në vlerën 2,265,889 lekë.*

1.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, për sa i përket mosdeklarimit nga deklarata periodike të vitit 2009, vendparkimin me nr. 8, shpjegoi se nuk e konsideron si fshehje pasurie por si mangësi në deklarim pasi nuk ka bërë një përshkrim të plotë të pasurisë nisur nga fakti që “parkimi” ishte i pasqyruar në kontratë dhe në planimetrinë e kontratës.

1.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, për sa i përket mospërputhjeve për pjesën takuese të këtij apartamenti mospërputhjet e deklarimeve të cilat shpjegon me faktin se i ishte referuar Kodit të Familjes, regjimi i ndarjes së pjesëve takuese në mënyrë të barabartë ndërmjet bashkëshortësh, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, kjo pronë nuk rezulton e regjistruar pranë ZVRPP-së.

1.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, për të provuar diferencën e shumës së apartamentit përfituar si ulje nga shoqëria ndërtuese, dhe për vërtetimin e gjendjes fizike të apartamentit e kryerjes së punimeve, i paraqiti Komisionit për provë situacionet e punimeve për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, të nënshkruara nga dy inxhinierë të shoqërisë.

1.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive për vitin 2009 shpjegoi si më poshtë:

Për sa i përket shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPI-së, të përcaktuara në vlerën 683.036 lekë, këto shpenzime kanë qenë shumë herë më të ulëta, për shkak se është ndjekur një regjim shumë i rreptë kursimi; lëvizjet me automjet për takime pune si dhe shpenzimet telefonike janë mbuluar nga ana e institucionit për shkak të detyrës si kryetare e gjykatës; fëmijët kanë qenë përkatësisht në moshën 5 dhe 4 vjeç dhe nuk kanë pasur shpenzime, pasi frekuentonin kopshtin shtetëror dhe mbaheshin prej prindërve. Konsumi familjar ka qenë i kufizuar vetëm në pjesën ushqimore dhe veshjeve bazë.

1.11 Për blerjen e pasurisë, apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 107,08 m², të shlyer në shumën 72,000 euro, është përdorur dhe huaja në shumën 12.000 euro, marrë shtetasit A. L., sipas deklaratës noteriale nr. (*) rep., nr. (***) kol., datë 21.12.2010, e cila nuk është llogaritur në analizën financiare të Komisionit.**

Arsyetimi ligjor

1.12 Duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) e deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së (iii) provat shkresore nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni, arsyeton se:

1.13 **Për mospërputhjet për pjesën takuese të këtij apartamenti**, në deklaratën “Vetting”, në pjesë ideale (50%), me deklarimin e vitit 2009 (100%), Komisioni i konsideron të plota shpjegimet duke e konsideruar të provuar të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit administrativ.

1.14 **Për mosdeklarimin e parkimit**, Komisioni, i konsideron të plota shpjegimet duke e konsideruar të provuar të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit administrativ.

1.15 **Për diferencën e shumës së apartamentit përfituar si ulje nga shoqëria ndërtuese, Komisioni, arsyeton se**, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinimet të rremë në deklaratën “Vetting”, në lidhje me kështin e fundit prej 25,664 eurosh, përfituar zbritje për apartamentin sa më poshtë:

1.15.1 Për diferencën e shumës së apartamentit përfituar si ulje nga shoqëria ndërtuese për punimet e kryera nga vetë porositësi, Komisioni, pasi analizoi 6 fletët e situacioneve të punimeve për 4 vite kalendarike 2010, 2011, 2012 dhe 2015³, paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit vëren se:

- (I) Situacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2010, 2011, 2012 vijnë në kundërshtim me deklarimet e subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e vitit 2014 mbajtur pranë ILDKPKI-së, (*paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit*) në të cilin subjekti i rivlerësimit deklaroi ekzistencën e kështit të papaguar ndaj firmës ndërtuese, në vlerën 25.664 euro, kësht që do të paguhet kur të regjistrohet kjo pronë në hipotekë. Nëse do të ishte e vërtetë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të do të kishin përfituar zbritje deri në vitin 2014 nga firma e ndërtimit sipas situacioneve ato duhet të ishin pasqyruar në procesverbalin e vitit 2014 pranë ILDKPKI-së.
- (II) Situacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për zbritje të përfituara në vitin 2010 vijnë në kundërshtim me deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë mbajtjes së procesverbalit të fundit vitit 2010 mbajtur pranë ILDKPKI-së (*paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit*) në të cilin subjekti i rivlerësimit deklaroi ekzistencën e kështit të papaguar ndaj firmës ndërtuese në vlerën 25.664 euro. Nëse do të ishte e vërtetë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të do të kishin përfituar zbritje për vitin 2010 nga firma e ndërtimit sipas situacionit të vitit 2010 në shumën 3,000 euro, kjo zbritje duhet të ishte pasqyruar në procesverbalin e vitit 2010 pranë ILDKPKI-së.
- (III) Fiktiviteti i situacioneve të viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2015 rezulton edhe në përmbajtje të tyre pasi subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë përfituar

³ Viti 2010 - suvatime të brendshme, sasia 230 m², vlera 1495 euro, instalime elektrike, çelësa - priza, automat, sasia 92 copë, vlera 1,150 euro. Instalime hidraulike, sasia 92, vlera 920 euro. Viti 2011 suvatime të brendshme sasia 150 m², vlera 975 euro, instalime elektrike, çelësa - priza, automat sasia 92, vlera 1,150 euro. Instalime hidraulike sasia 92, vlera 920 euro. Mermere në prag dyerësh, dritarësh etj sasia 65, vlera 390 euro. Viti 2012 nënshkresa niveluese sasia 92 m², vlera 497 euro, instalime elektrike, çelësa - priza, automat sasia 92, vlera 1150 euro, instalime hidraulike sasia 92, vlera 920 euro. Viti 2013, grila duralumini me kasonetë sasi 25.70 me vlerë 1,414 euro. Viti 2014, dritare + vetrata duralumini sasia 23.70 me vlerë 2015 euro Viti 2015 patinim+astarim i mureve dhe tavaneve sasia 380 m², vlera 1064 euro, instalime elektrike, çelësa - priza, automat sasia 92, vlera 1150 euro, instalime hidraulike sasia 92, vlera 920 euro.

zbritje nga firma e ndërtimit për të njëjtat punime të kryera nga vete porositësi në të njëjtën sasi dhe të njëjtën vlerë⁴.

- (IV) Situacionet e paraqitura janë të pashoqëruara me dokumentacion rakordimesh mes palëve si dhe janë bërë nga dy inxhinierë të ndryshëm të shoqërisë nga të cilët është paraqitur autorizim përfaqësimi, vetëm për njërin prej tyre.
- (V) Për një situacion subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion ligjor për përfaqësimin e firmës ndërtuese nga inxhinieri. Situacionet e tjera të firmosura nga inxhinieri i firmës janë paraqitur në mungesë të dokumentacionit ligjor për tagrin e përfaqësimit të firmës ndërtuese nga inxhinieri që ka firmosur këto situacione.
- (VI) Situacionet e punimeve janë paraqitur nga ana e subjektit vetëm në deklarin e vitit 2016 e jo në deklarimet periodike të periudhës 2010 - 2015.
- (VII) Referuar sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e vitit 2014 ku deklarohet se kësti i fundit do paguhet me hipotekimin e apartamentit dhe nuk përmendet as referohet zbritje për punime të kryera nga vetë porositësi.

1.15.1.1 Komisioni, arrin në përfundimin se deklarimi në deklaratën “Vetting” i subjektit të rivlerësimit, se ka përfituar zbritje nga shoqëria e ndërtimit për punime të kryera nga vetë porositësi është një deklarin i rremë i subjektit të rivlerësimit.

1.15.2 Për diferencën e shumës së apartamentit përfituar si ulje nga shoqëria ndërtuese, për zbritje nga firma ndërtuese, për arsye të dorëzimit me vonesë të apartamentit në vitin 2016, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe vëren se:

1.15.2.1 Në procesverbalin e datës.15.09.2014, mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, **se për këtë apartament janë dorëzuar çelësat e tij** dhe është në pritje të regjistrimit dhe hipotekimit nga firma ndërtuese.

1.15.2.2 Në procesverbalin e datës.15.09.2014, mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 25,664 eurosh, këst i fundit do paguhet kur të hipotekohet apartamenti.

1.15.2.3 Komisioni, arsyeton se deklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si dhe në përgjigje të barrës së provës, sipas të cilave dorëzimi i apartamentit është bërë në vitin 2016, vijnë në kundërshtim me deklarimet që ajo vetë ka bërë në procesverbalin e vitit 2014 pranë ILDKPKI-së, ku ajo pohon se ka marrë çelësat e apartamentit, duke konfirmuar se është kryer dorëzimi faktik i këtij apartamenti.

1.15.2.4 Komisioni, arrin në përfundimin se deklarimi në deklaratën “Vetting” i subjektit të rivlerësimit, se ka përfituar zbritje nga shoqëria e ndërtimit për marrjen në dorëzim me vonesë të apartamentit në vitin 2016, është një deklarin i rremë i subjektit të rivlerësimit.

1.2 Lidhur me kontratë huaje lidhur me shtetasin A. M., për vlerën 60,000 euro.

Faktet nga hetimi administrativ

1.2.1 Si burim krijimi për këtë apartament ka shërbyer, kontratë huaje me shtetasin **A. M.**, nr. (***) rep., nr. (***)⁵kol., datë 20.10.2008, në shumën 60,000 euro, me afat 5 vjet, me interes 3 %.

1.2.2 Në bazë të dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ, vërehet se shtetasi **A. M.**, është i regjistruar si person fizik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, më datë 12.04.2005, si person fizik, me NIPT (***) dhe ka kaluar në statusin pasiv më datë 06.05.2016.

1.2.3 Shtetasi **A. M.**, nga viti 2005 deri në vitin 2008, vit në të cilin i ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën prej 60,000 eurosh - ka një qarkullim nga ushtrimi i aktivitetit tregtar në vlerën 6,500,000 lekë dhe fitim në vlerën 432,000 lekë.

1.2.4 Me pyetësin nr. 2, datë 09.05.2018, Komisioni, ka pyetur subjektin e rivlerësimit të sqarojë: a) Marrëdhënien që kanë me shtetasin A. M.; b) mundësitë financiare të A. M. për të dhënë hua c) të paraqesë dokument justifikues në lidhje me pagesat; ç) të shpjegojë nëse është paguar interesi 3 % i shumës së marrë hua.

1.2.5 Subjekti në përgjigje të pyetësit nr. 2 ka deklaruar se me shtetasin A. M., bashkëshorti i subjektit, z. M. L., ka pasur marrëdhënie të ngushta shoqërore prej vitesh si dhe marrëdhënie huamarrje. Ky person ka pasur aktivitet biznesi dhe të ardhurat nga aktivitete e tij të ligjshme përbëjnë burimet financiare të këtyre huadhëniesve. Pagesat periodike për shlyerjen e këtyre huave janë bërë në dorë *cash*, sipas vlerave në deklaratat periodike vjetore.

1.2.6 Kontrata e huas e lidhur me shtetasin A. M., më datë 20.10.2008, ka pasur një afat 5-vjeçar, deri më datë 20.10.2013, dhe interes 3 % në vit. Nga kjo kontratë janë bërë likuidimet e kësteve deri në muajin janar 2013, kohë kur, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të këtij shtetasi është kërkuar likuidimi total i detyrimit, përpara afatit, duke hequr dorë edhe nga interesat, me qëllim marrjen e menjëhershme të kësaj huaje.

1.2.7 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Ka mungesë dokumentacioni ligjor provues për burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të dhëna hua, nga shtetasi A. M., për hua në shumën 60,000 euro në vitin 2008; dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si dhe për pagesat periodike të bëra për shlyerjen e kësaj huaje; heqjen dorë nga interesat në marrëveshjen për likuidimin total të detyrimit përpara afatit, huaja është likuiduar 8 muaj përpara afatit të parashikuar në kontratë, dhe sipas parashikimeve të kontratës, duhet të ishte paguar interesi vjetor prej 3 % në vitet 2009, 2010, 2011, 2012.*

1.2.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se shtetasi A. M., ka pasur aktivitet ekonomik dhe për rrjedhojë ka siguruar edhe të ardhura. Të ardhurat e evidentuara nga DRT-ja Vlorë i referohen, vetëm qarkullimit të tij ekonomik dhe jo gjendjes së tij financiare në likuiditete, që nuk lidhen me statusin e tij si person fizik, që ushtron aktivitet tregtar, pasi ai ka pasur likuiditete jashtë sistemit bankar.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së; (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii) provat shkresore nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; Komisioni arsyeton se:

1.2.9 Nga hetimi administrative rezultoi e provuar se shtetasi A. M., është regjistruar si person fizik, më datë 12.04.2005 dhe deri në vitin 2008, vit në të cilin është dhënë huaja për

bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, ka realizuar fitim si person fizik me NIPT (***), në vlerën **432,000 lekë/vit**.

Vitet	Qarkullimi	Fitimi
2005	2,000,000	432,000
2006	2,500,000	432,000
2007	S'ka informacion	432,000
2008	2,000,000	432,000

1.2.10. Nga dokumentacioni ligjor provues i mësipërm i siguruar nga hetimi administrativ, nuk është arritur të provohet ligjshmëria e të ardhurave të dhëna hua nga shtetasi A. M., në shumën prej **60,000 eurosh, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj.**

1.2.11 Shpjegimi që ka dhënë subjekti i rivlerësimit sipas të cilit shtetasi A. M. ka pasur likuiditete jashtë sistemit bankar është i pabazuar në ligj e në prova, pasi nuk u depozitua prej saj, asnjë dokumentacion ligjor e nuk u arrit të provohet, sa pretendohet se huadhënësi ka pasur likuiditete të tjera.

1.2.12 Shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për likuidimet e kësteve deri në muajin janar 2013, kohë kur, është kërkuar likuidimi total i detyrimit, përpara afatit, duke hequr dorë edhe nga interesat, nuk arriti të shpjegojë se përse deri në vitin 2013, nuk është bërë pagimi i interesave të huas, ndaj shtetasit A. M.

1.3 Lidhur me huan 12,000 euro të marrë nga shtetasi A. L.

Faktet nga hetimi administrativ

1.3.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar hua pa afat në shumën 12,000 euro, marrë vëllait të bashkëshortit të subjektit e përdorur si burim për krijimin e këtij apartamenti sipas deklaratës noteriale, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 21.12.2010.

1.3.2 Pas analizimit të deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit rezultoi se dhënia e huas sipas deklaratës noteriale, më datë 21.12.2010, është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2013. Kjo hua nuk është deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike të viteve 2009 - 2012 nga subjekti i rivlerësimit.

1.3.3 Në deklarin periodik të vitit 2009, vit kur pretendohet se është dhënë kjo hua, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi marrjen e kësaj huaje nga vëllai i bashkëshortit. Në vitin 2010 subjekti i rivlerësimit është thërritur pranë ILDKPI-së dhe i është kërkuar shpjegim për burimin e ligjshëm të krijimit të këtij apartamenti dhe ka deklaruar se ka marrë dhe një hua nga vëllai vetëm pasi është konstatuar mungesa e burimeve të ligjshme nga ana e këtij institucioni.

1.3.4 Z. A.L., në cilësinë e huadhënësit, ka qenë subjekt rivlerësimi nga viti 2013 e në vazhdim në deklaratat periodike vjetore të tij pranë ILDKPI-së, nuk e deklaroi asnjëherë këtë hua.

1.3.5 Huadhënësi, shtetasi A. L., është i regjistruar si administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k., me NIPT (***), në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, më datë 10.10.2005, dhe është me status aktiv.

1.3.6 Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk ka të dhëna lidhur me të ardhurat nga pagat për shtetasin A. L. deri në vitin 2009, vit në të cilin është dhënë huaja.

1.3.7 Me pyetësorin nr. 2, datë 09.05.2018, Komisioni, ka pyetur subjektin e rivlerësimit të sqarojë: a) marrëdhënien me z. A. L.; b) Burimet e ligjshme të krijimit të të ardhurave të dhëna hua.

1.3.8 Subjekti ka deklaruar: Marrëdhënien familjare me z. A. L. si vëllai i bashkëshortit të subjektit si dhe marrëdhënie huamarrje. Burimi i kësaj huadhënie janë të ardhura nga aktivitetet biznesi.

1.3.9 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Rezulton se kjo hua është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2013, ajo nuk është deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2009 deri në vitin 2012.*
- *Referuar deklaratave periodike pranë ILDKPKI-së të z. A. L., nuk rezulton që ai të ketë deklaruar dhënie huaje 12,000 euro vëllait të tij, shtetasit M. L.*
- *Nuk është dorëzuar dokumentacion ligjor provues për të provuar se huadhënësi, shtetasi A. L., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua shumën 12,000 euro në vitin 2009.*

1.3.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se në kushtet që kjo hua është dhënë pa kontratë noteriale dhe pa interes, midis personave në marrëdhënie të afërt familjare (*vëllezër*) në deklarimin e vitit 2009, nuk është deklaruar kjo hua, për shkak të mungesës së njohurive të përshtatshme për plotësimin e deklaratës periodike të vitit 2009.

1.3.11 Shtetasi A. L., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua këtë shumë, pasi ai është administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k, me (***), i regjistruar në DRT-në Vlorë, që në vitin 2005, aktivitetet nga i cili ka realizuar një ndërtim shumëkatësh, duke përfituar të ardhura të konsiderueshme.

1.3.12 Aktiviteti i tij është i organizuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e për rrjedhojë nuk deklaron tërheqje dividendi, pasi ai është ortaku dhe administratori i kësaj shoqërie.

Të ardhurat e tij nga aktiviteti privat i ndërtimit janë të konsiderueshme. Ai ka realizuar ndërtimin e një kompleksi banimi dhe shërbimi, në zonën e quajtur “F. O.” në Vlorë nga ku ka përfituar apartamente dhe njësi shërbimi të cilat i ka dhënë me qira, duke përfituar të ardhura;

1.3.13 Fakti, që z. A. L., si subjekt deklarimi nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaratimet e tij periodike vjetore mund të jetë një harresë apo gabim administrativ nga ana e tij, për të cilin nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni arsyeton se:

1.3.14 Neni 79 i Kodit Civil shprehet se: *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.*

1.3.15 Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, shprehet se: “Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre”

1.3.16 Mbështetur në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni, arsyeton se:

Kontrata e huas, më datë 21.12.2010, për një huamarrje të vitit 2009 është një veprim fiktiv i simuluar, mes palëve që nuk ka pasur qëllim krijimin e asnjë pasoje juridike por ka pasur si qëllim, justifikimin e shumës prej 12,000 eurosh, përdorur për blerjen e apartamentit, bazuar në:

- i. Ka mosdeklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit për këtë hua në vitin 2009 kur pretendohet se është marrë kjo shumë, për më tepër në këtë vit si burim krijimi referohen të ardhura nga pagat dhe kursimet dhe nuk referohen hua të marra.
- ii. Procesverbali i depozituar si provë nga subjekti i rivlerësimit është mbajtur, më datë 20.12.2010, përpara ILDKPKI-së dhe në të është konstatuar mungesa e burimeve financiare për vitin 2009, për subjektin e rivlerësimit.
- iii. Vetëm një ditë më pas subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i bashkëshortit të subjektit kanë hartuar deklaratën noteriale, më datë 21.12.2010, e cila nuk është bërë në kohën e marrjes së kësaj huaje, por pas një viti.
- iv. Në deklaratat periodike të tij, të huadhënësit z. A. L., si subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, nuk deklarohet asnjëherë shuma e dhënë hua vëllait prej 12,000 eurosh.

1.3.17 Komisioni, arsyeton se provat dhe faktet e analizuara më sipër krijojnë bindjen e Komisionit për veprim “fiktiv” midis palëve, në lidhje me shumën e dhënë hua nëpërmjet deklaratës noteriale nga vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

1.3.18 Shtetasi A. L., rezulton të jetë ortak dhe administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k. Nga viti 2005 e deri në vitin 2016 ky subjekt ***nuk ka deklaruar në asnjë vit tërheqje dividendi nga aktiviteti tregtar***, që do të thotë se fitimet e gjeneruara nga ky subjekt tregtar nga viti 2005 deri në vitin 2016 ***nuk ka qenë e mundur të përdoren prej tij*** si burim për huan që ai i ka dhënë vëllait të tij, z. M. L.

1.3.19 Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për të provuar sa ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga apartamentet dhe njësitë e shërbimit të cilat i ka dhënë me qira, për të provuar se ka përfituar të ardhura për të cilat janë paguar tatimet për këto pasuri.

1.4 Lidhur me kontratën e huas lidhur me shtetasin K. S., për vlerën 30,000 euro.

Faktet nga hetimi administrativ

1.4.1 Në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti ka deklaruar, kontratë huaje nga z. K. S., nr. (***) rep, nr(***)kol, datë 14.01.2013, në shumën 30,000 euro me interes 3 %, me afat 3 vjet, deri më datë 13.01.2016, si burim për krijimin e këtij apartamenti.

1.4.2 Shuma prej 30,000 eurosh është marrë hua nga z. K.S., me qëllim likuidimin e detyrimit ndaj huadhënësit A.M.

1.4.3 Nga hetimi administrativ, rezultoi se shtetasi K. S. është i regjistruar si person fizik në DRT-në Vlorë, më datë 24.03.2005, me NIPT(***) , me status aktiv.

1.4.4 Qarkullimi nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, nga viti 2005 deri në vitin 2013, është në vlerën 5,267,382 lekë, dhe fitim në vlerën 1,672,790 lekë. Nga të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, shtetasi K. S., ka të ardhura nga paga neto, nga muaji janar deri në dhjetor 2012, në vlerën 110,086 lekë.

1.4.5 Me pyetësin nr. 2, datë 09.05.2018, është pyetur subjekti i rivlerësimit të sqarojë në lidhje me: a) marrëdhënien me huadhënësin K. S.; b) burimet financiare për dhënien e kësaj huaje; c) pagesat periodike të këtyre pagesave.

Subjekti ka deklaruar: Se me këtë shtetas b/shorti ka lidhje shoqërore. Burimet e këtyre huave janë nga burime financiare të ligjshme.

1.4.6 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

Nisur nga këto dhënat e administruara, duket se shtetasi K. S. ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare për t'i dhënë huan prej 30,000 eurosh bashkëshortit të subjektit.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi si më poshtë:

“Për sa i përket kontratës së huas të lidhur me shtetasin K. S. në vlerën 30.000 euro, ky shtetas ka pasur aktivitet ekonomik dhe për rrjedhojë ka siguruar edhe të ardhura. Të ardhurat e evidentuara nga DRT-ja Vlorë i referohen, vetëm qarkullimit të tij ekonomik dhe jo gjendjes së tij financiare në likuiditete, pasi ky shtetas ka edhe të ardhura të tjera nga familjarët e tij, me të cilët bashkëjeton, konkretisht babai i tij ka pronësi të cilat i ka dhënë me qira, duke siguruar minimalisht të ardhura mujore prej 5,500 USD në muaj që prej vitit 2009”.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni, arsyeton se:

1.4.7 Komision, analizoi kontratën e qirasë, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 04.05.2009, të lidhur me qiradhënësin M. S. dhe E. S., me qiramarrës “(***)” sh. a., për dhënien me qira të një objekti me çmimin prej 5,500 USD, në paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e shtetasit K. S.

1.4.8 Kjo kontratë e paraqitur është lidhur mes palëve por subjekti nuk provoi se sa ka qenë kohëzgjatja e saj, nëse ka vazhduar sipas parashikimeve apo është zgjidhur para afatit të përcaktuar në kontratë.

1.4.9 Kjo kontratë është lidhur mes qiradhënësve, prindërve të shtetasit z. K. S., dhe nuk rezulton se z. K. S. është palë në këtë kontratë, as si qiradhënësi as si përfitues i të ardhurave.

1.4.10 Referuar regjistrimit të gjendjes civile rezulton se shtetasi K. S. ka edhe 3 vëllezër të tjerë.

Për sa më sipër përfitimi i shumave nga qiradhënia si të ardhura të ligjshme nga shtetasi K. S. mbetet e pa provuar me dokumentacion provues.

1.4.11 Nga dokumentacioni i marrë nga DRT-ja Vlorë u provuar se shtetasi K. S. ka një qarkullim nga ushtrimi i aktivitetit tregtar nga viti 2005 deri në vitin 2013, në vlerën **5,267,382 lekë, qarkullim i cili i takon viteve 2011 - 2013, dhe fitim në vlerën 1,672,790 lekë.**

1.4.12 Instituti i Sigurimeve Shoqërore informoi se shtetasi K. S. ka pasur të ardhura nga paga neto, nga muaji janar deri në dhjetor 2012 në vlerën 110,086 lekë, duke mos provuar të ardhurat e ligjshme të dhëna hua bashkëshortit të rivlerësimit.

Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues në lidhje me këtë apartament arrin në përfundimin se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit A. M. për dhënien hua të shumës 60,000 euro.
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit K. S., për dhënien hua të shumës 30,000 euro.
- iii) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me huan e marrë shtetasit A. L., në shumën prej 12.000 eurosh.
- iv) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me uljen e përfituar në shumën 25.664 euro, nga shoqëria ndërtuese për këtë apartament banimi, me sipërfaqe 107.08 m² + vendparkim me nr(***) , sipas kontratës së sipërmarrjes, nr. (***)rep., nr. (***)kol., datë 12.12.2009, për dorëzim me vonesë nga firma e ndërtimit dhe punime të kryera nga porositësi.
- v) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Pasuria, apartament banimi, me sipërfaqe 100.68 m² + vendparkim nr. (*) , ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë.**

Faktet nga hetimi administrativ

2.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, apartament banimi, me sipërfaqe 100.68 m², nr. (***) , 2+1, K. (***) + vendparkim nr. (***) , Rr.” (***)”, Tiranë, sipas kontratës për kalim të drejtash reale, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 25.07.2016, lidhur me shtetasit P. Ç. dhe P. Z., shoqërinë “(***)” sh.p.k dhe shoqërinë “(***)” sh.p.k. Burimi i krijimit: Kontrata e huas, nr. (***)rep., nr(***)kol., datë 02.07.2016, të lidhur me huadhënësin L. S., për vlerën 70,000 euro, me interes 3 % në vit, me afat 5 vjeçar. Vlera: 60,000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

2.2 Me pyetësin nr. 2, datë 09.05.2018, Komisioni, ka pyetur subjektin e rivlerësimit të sqarojë: Kur dhe si është bërë pagesa e çmimit për këtë apartament; b) Cili është qëllimi/arsyeja që dy shitësit e mësipërm t’ua shisnin juve këtë apartament në vitin 2016 me gati 22,000 euro më lirë se çmimi që ata paguan kur e blenë vetë në vitin 2009; c) Përse pagesa e këtij apartamenti është bërë jashtë zyrës noteriale në vitin 2016, në një kohë kur Udhëzimi, nr. 6915/2, datë 30.1.2012, parashikon që çmimi i blerjes depozitohet te llogaria e noterit dhe më pas i kalohet shitësit?

2.3 Subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 2, ka deklaruar se, me shitësit e mësipërm ka rënë dakord, që në vitin 2014 për blerjen e kësaj pasurie dhe me marrëveshje të palëve edhe kontratat e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm janë lidhur në emër të shtetasit M. L. Gjatë kësaj periudhe ka negociuar për çmimin dhe në momentin që kemi realizuar marrjen e huas, kemi bërë edhe pagesën e vlerës përkatëse, sipas kontratës. Shitja në vlerën e mësipërme

është bërë në marrëveshje mes palëve, pasi shitësve iu interesonte pagesa e menjëhershme *cash* dhe nuk iu nevojitej më kjo pronë dhe kërkonin ta tjetërsonin, pavarësisht çmimit të blerjes, që kishin shpenzuar ata vetë në vitin 2009. Kjo kontratë nuk është regjistruar ende pranë ZVRPP-së.

2.4 Në lidhje me pyetësonin që i është drejtuar, subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur pyetjes *“kur dhe si është bërë pagesa për këtë apartament”*.

2.5 Komisioni, me shkresën nr. (***) prot., datë 06.02.2018, i është drejtuar ZVRPP-së Tiranë, ku i ka kërkuar informacion nëse ka pasuri të paluajtshme të regjistruara në Tiranë në emër të subjektit dhe të personave të lidhur me të.

2.6 ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.02.2018, drejtuar Komisionit ka konfirmuar se në emër të subjektit si dhe personave të lidhur me të, nuk figurojnë pasuri.

2.7 Komision, me shkresën nr. (***) prot., datë 06.02.2018, drejtuar OSHEE-së ka kërkuar informacion në lidhje me kontratat e mundshme të energjisë që mund të ketë lidhur subjekti dhe personat e lidhur me të për apartamentet apo shtëpitë në pronësi apo posedim.

2.8 Referuar kontratës për kalim të drejtash reale, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 25.07.2016, me palë të parë P. C. dhe P. Z., palë e dytë M. L., palë e tretë shoqëria *“(***)”* sh.p.k dhe shoqëria *“(***)”* sh.p.k., me objekt, Ap. B2 (2+1), K. VI, me sip.100.68 m² dhe vendparkim nr. 7, të nenit 3, paragrafi 3, sqarohet se: *“Palët kanë rënë dakord që çmimi i apartamentit dhe vendparkimit të jetë në shumën prej 60,000 eurosh, palët deklarojnë se është paguar me pjesë të ndryshme më parë dhe konsiderohet e paguar plotësisht, e pa pretendime nga palët”*

2.9 Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar në deklaratimet periodike të mëparshme ndër vite pranë ILDKPI-së pagesa me pjesë të ndryshme në lidhje me shlyerjen e vlerës prej 60,000 eurosh, por në vitin 2016, deklaroi vetëm shumën 60,000 euro të paguar plotësisht.

2.10 Referuar kontratës së sipërmarrjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 12.12.2009, me sipërmarrës shoqëria *“(***)”* sh.p.k dhe shoqëria *“(***)”* sh.p.k dhe porositës P. C. dhe P. Z., me objekt, Ap. B2, (2+1), K. VI, me sip.100.68 m² dhe vendparkim nr. 7, rezultoi se vlera totale e kësaj kontrate është 81,922 euro.

2.11 Pra, shitësit i kanë shitur subjektin të rivlerësimit, një pasuri të paluajtshme në vlerën 21,922 euro më pak se çmimi i blerë nga ana e tyre.

2.12 Bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, *“Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave”* nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016 çmimi mesatar për shitblerjen e banesave në tregun e lirë për vitin 2016 për qytetin e Tiranës për zonën (***)parashikohet çmimi për m² në vlerën 130,000 lekë/m².

2.13 Kursi zyrtar i këmbimit valutor, më datë 26.07.2016, sipas Bankës së Shqipërisë (pasi më datë 25.07.2016 nuk ka info) është 1 euro =136.28 lek. 130,000 lekë/m² : 136.28 lekë = 953.9 euro/m² Në një llogari të përafërt vlera totale e apartamentit, verandës dhe vendparkimit për vitin 2016 është afërsisht 121,491 euro.

2.14 Në deklaratën *“Vetting”* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin dhe vendparkimin, por nuk ka deklaruar verandën e cila si pjesë e çmimit total të blerjes nuk është deklaruar as në deklaratën periodike të vitit 2016.

2.15 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektivit të rivlerësimit për mungesë dokumentacioni ligjor provues për:

- *Ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të dhëna hua për të provuar se huadhënësi, shtetasi L. S., ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për t'i dhënë hua shumën 70,000 euro në vitin 2016 shtetasit M. L.*
- *Likuidimin e vlerës së apartamentit 60,000 euro; shlyerjen e huas 60,000 euro deri në vitin 2016 (mungesë deklarimi deri në 2016).*
- *Rezulton se vlera e blerjes së këtij apartamenti është 81,922 euro, shitur 21,922 euro më pak për një periudhë të shkurtër (në vitin e blerjes vlera e tregut të apartamentit në këtë vit 120,000 euro). Shpjegimet e tuaja në pyetësor janë të paqarta e kontradiktore lidhur me këtë fakt.*
- *Rezulton se nuk është deklaruar veranda e këtij apartamenti as në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, as në deklarinimin periodik të vitit 2016.*

2.16 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se në momentin e dhënies së huas, shtetasi L. S., ka pasur të ardhura të mjaftueshme pasi ka pasur të ardhura nga shoqëria “(***)” sh.p.k., ku ka qenë ortak me 50 %, duke paraqitur edhe ekstraktin e lëshuar nga QKB-ja, ekstrakt i thjeshtë dhe pasqyrat financiare për vitin 2012 dhe 2013. Kontrata e huas, më datë 02.07.2016, lidhur me shtetasin L. S., është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 si detyrim në shumën sipas kontratës së huas, por nuk janë bërë deklarime periodike të shlyerjes së saj, sepse nuk është bërë asnjë likuidim, sepse kontrata parashikon që shuma e dhënë hua, së bashku me interesat, do të likuidohet më datë 02.07.2021.

2.17 Me shitësit P. Ç. dhe P. Z. është rënë dakord, që në vitin 2014, për blerjen e kësaj pasuri dhe kontratat e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm janë lidhur në emër të shtetasit M. L. sipas marrëveshjes midis palëve. Gjatë kësaj periudhe është diskutuar çmimi i shitjes së apartamentit dhe vendparkimit dhe në momentin që është realizuar marrja e huas, pra sigurimi i likuiditeteve për blerjen e tyre, kemi bërë edhe pagesën e vlerës përkatëse, sipas kontratës.

Shitja në vlerën e mësipërme është bërë në marrëveshje mes palëve, pasi shitësve iu interesonte pagesa e menjëhershme *cash* dhe nuk iu nevojitej më kjo pronë për shkak të vonesave të mëdha në përfundimin e objektit dhe hapjen e vendparkimeve, që ende nuk janë hapur për përdorim.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektivit të rivlerësimit në deklaratën – “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni, arsyeton se:

2.18 Komisioni, analizoi deklaratën noteriale, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 01.11.2018, të shtetasit L. S., paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit.

2.19 Me anë të kësaj deklarate, deklaruesi konfirmon dhënie hua shtetasit M. L., shumën prej 70,000 eurosh, sipas kontratës së huas, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 02.07.2016, me interes 3 % në vit, afat 5 vjeçar dhe likuidim brenda vitit 2021, duke deklaruar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme pasi ka pasur të ardhura nga shoqëria “(***)” sh.p.k., ku ka qenë ortak me 50 % të saj.

2.20 Pas analizimit të kësaj deklarate dhe verifikimit të kryer ana e Komisionit në faqen zyrtare të QKB-së të ekstraktit historik, rezulton se, më datë 25.03.2014, statusi i shoqërisë “(***)” sh.p.k., nga status “aktiv” ka kaluar në statusin “pezulluar”.

2.21 Sipas dokumentacioni të dërguar Komisionit, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, subjekti tregtar “(***)” sh.p.k është regjistruar si person fizik, më datë 10.01.2008, për ushtrimin e aktivitetit në fushën e ndërtimit, në fushën e tregtisë, import-eksport.

2.22 Pasqyrat financiare të vëna në dispozicion nga subjekti për këtë shoqëri i takojnë viteve 2012 - 2013, ndërkohë që, më datë 20.03.2014, është vendosur “Pushim i përkohshëm i aktivitetit’ dhe statusi nga “aktiv” u bë “pezulluar”, e për vitin paraardhës 2013 ky subjekt tregtar rezulton se ka një humbje prej 35,738 lekësh, në veprimtarinë financiare të tij.

2.23 Nga informacioni i vënë në dispozicion për periudhën 2008 - 2012, subjekti “(***)” sh.p.k., ka në total për të gjitha këto vite një fitim na vlerën 15,169,370 lekë.

Vitet	Qarkullimi	Fitimi	Dividenti
2008	18,245,265	2,714,622	0
2009	42,489,812	5,895,205	0
2010	48,616,609	4,834,205	0
2011	23,403,978	2,622,373	0
2012	12,836,128	1,191,395	0
2013	0	-35,738	0
2014	Ska info	Ska info	0

Nisur nga kjo analizë rezulton se ky shtetas i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit të ardhura të cilat nuk rezultojnë të jenë shpërndarë gjatë viteve si dividendë dhe në këtë mënyrë nuk mund të përdroshin si burim i ligjshëm për dhënien e huas ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

2.24 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore për sa i përket pagesave periodike të shlyerjes së vlerës së apartamentit në total në shumën 60,000 euro pasi:

2.24.1 Në kontratën e kalimit të së drejtave reale të pasurisë, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 25.07.2016, palët kanë deklaruar se e kanë paguar pjesën dhe e konsiderojnë të paguar plotësisht, e pa pretendime.

2.24.2 Në deklaratën noteriale, më datë 31.10.2018, lëshuar nga shitësit, paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit deklarohet se pagesa është bërë menjëherë në *cash*, në momentin e lidhjes së kontratës së kalimit të së drejtave reale të pasurisë.

2.25 Komision, arsyeton subjekti i rivlerësimit, nuk arriti të shpjegojë se me çfarë tagri ligjor është hapur kontrata e energjisë dhe ujit në emër të bashkëshortit të saj për këtë apartament.

Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit L. S. për dhënien hua të shumës 70.000 euro.
- ii) Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim apo përdorim të tij.

- iii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

3. Pasuria, apartament banim, me sipërfaqe 71.80 m², ndodhur në Vlorë.

Faktet nga hetimi administrativ

3.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar: pasurinë, apartament banim, me sipërfaqe 71.80 m², nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***). Burimi i krijimit: Krijuar nga kontrata e shkëmbimit me Ndërmarrjen Elektrike Vlorë. Vlera: Nuk është shënuar. Pjesa takuese:100 %.

3.2 Komisioni, me shkresën nr(***)prot., datë 06.02.2018, drejtuar ZVRPP-së Vlorë, ka kërkuar informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, si dhe personave të lidhur me të.

3.3. ZVRPP-ja Vlorë me shkresën, nr. (***)prot., datë 28.02.2018, drejtuar Komisionit ka dërguar informacion e kërkuar dhe konfirmon se në emër të z. M. L., rezulton pasuri në ZK (***) ,nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), lloji i pasurisë, apartament, me sip. 71.8 m², por nuk ka bashkangjitur asnjë dokument për mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti.

3.4 Duke analizuar marrëveshjen e shkëmbimit:

3.5 Referuar aktmarrëveshjes shkëmbim pasurie, nr. (***) rep., nr. (***) prot., datë 25.07.2000⁶, përpara noter Y. A., me palë, z. H. Gj. me cilësinë e Drejtorit të Elektrikut Vlorë në rolin e shkëmbyesit të pasurisë dhe z. M. L. në rolin e shkëmbyesit të pasurisë, në pronësi të z. M. L., ndodhur në lagjen “(***)” është një objekt ndërtimor 1- katësh me lartësi 4 m vërtetuar nga vërtetimi hipotekor, datë18.07.2000, ndërsa Ndërmarrja Elektrike Vlorë disponon kabinën elektrike nr. (***) në pallatin nr. (***) . Të dy palët kanë rënë dakord që ky kalim pronësie të bëhet nga njëri tek tjetri sipas dispozitave të Kodit Civil.

3.6 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Kontrata e shkëmbimit nuk përcakton se çfarë sipërfaqeje dhe me çfarë dokumentacioni provohet pronësia e Ndërmarrjes Elektrike Vlorë mbi këtë kabinë.*
- *Nuk sqarohet nëse apartamenti me sipërfaqe 71.8 m² është përfitur vetëm nga kabina dhe nëse bashkëshorti i subjektit ka pasur një ndërtesë tjetër në posedim, që i bashkëngjitet kabina.*
- *ZVRPP-ja Vlorë konfirmon se në lidhje me këtë apartament nuk disponon asnjë dokumentacion ligjor.*
- *Duket se nuk janë dorëzuar dokumente të mjaftueshme ligjore për të provuar mënyrën e fitimit të pronësinë mbi këtë pasuri.*

3.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi si më poshtë:

3.8 Në lidhje me këtë apartament, me sipërfaqe 71.80 m², nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), ndodhur në ZK (***) ,Vlorë, siç ka shpjeguar në përgjigjet e pyetjeve shtesë të dërguara nga ana e Komisionit, pasuria e sipërpërmendur është krijuar nga kontrata e shkëmbimit me Ndërmarrjen Elektrike Vlorë dhe figuron e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në emër të

⁶ Aktmarrëveshja, më datë 25.07.2000, rezulton e depozituar në dosjen e ILDKPKI-së nga vetë subjekti.

z. M. L., bashkëshortit të subjektit, që përpara vitit 2003, vit i lidhjes së martesës sime me këtë shtetas. Kjo pasuri është deklaruar rregullisht si pasuri e bashkëshortit përpara martesës, si dhe mënyra e krijimit të saj. Fakti, që pranë ZVRPP-së Vlorë nuk disponohet apo nuk është ruajtur dokumentacioni i referencës, që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj prone nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi bashkëshortin për ruajtjen e këtij dokumentacioni, i cili referohet rreth vitit 1998.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën – “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni, arsyeton sa më poshtë:

3.9 Subjekti i rivlerësimit në deklarin “Vetting” ka pasur detyrimin të dokumentojë me dokumentacion ligjor përfitimin e apartamentit me sip. 71.80 m². Në asnjë nga deklaratimet periodike subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të këtë paraqitur dokumentacion ligjor provues.

Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë, apartament me sip. 71.8 m².
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.

4. Pasuria, ndërtesë me sipërfaqe 120 m² dhe truallin 215 m²

Faktet nga hetimi administrativ

4.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar në pronësi të b/shortit, pasurinë, ndërtesë me sip. 120 m² dhe truall në përdorim të banesës 215 m², nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***). Burimi i krijimit: Leja e ndërtimit, nr. 41, datë 16.8.1991, të Komitetit Ekzekutiv.

Vlera: Nuk është e përcaktuar. Pjesa takuese: 100 %.

4.2 Në deklaratën e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pronësi të b/shortit banesë 3- katëshe, me sip. 3 00 m², vlera në lekë 5.000.000, ndodhur në lagjen “(***)” (regjistrimi në hipotekë, nr. (***), datë 03.10.2001). Burimi i krijimit: Nga kursimet. Vlera: 5.000.000. lekë. Pjesa takuese: 100 %.

4.3 Komisioni, me shkresën nr. (***), prot., datë 06.02.2018, drejtuar ZVRPP-së Vlorë, ka kërkuar informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dhe personave të lidhur me të.

4.4 ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. (***), prot., datë 28.02.2018, ka konfirmuar se në emër të z. M. L., rezulton e regjistruar, pasuria me nr. (***), vol. (***), fq. (***), lloji i pasurisë ndërtesë, me sip. 120 m². Bashkangjitur dhe dokumentacionin respektiv për këtë pasuri dhe konkretisht: a) Leje ndërtimi, nr. (***), datë 16.08.1991, lëshuar nga Komiteti Ekzekutiv; b) Vendim gjykate, nr. 166, datë 30.01.1996, me objekt: Detyrim njohje pronar mbi një ndërtesë; c) Vërtetim pronësie datë 14.02.1996.

4.5 Komisioni, me shkresën nr. (***) , datë 28.05.2018, drejtuar ALUIZNI-t Vlorë, ka kërkuar informacion nëse në emër të subjektit e personave të lidhur ka aplikime pranë kësaj drejtorie.

4.6 ALUIZNI Vlorë, me shkresën nr. (***) prot., datë 28.05.2018, drejtuar Komisionit, ka dërguar dokumentacionin që ndodhet në dosje në emër të z. M. L. a) Kërkesë datë 18.12.2017 e z. M. L., drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Vlorë; b) Procesverbal i verifikimit në terren datë 19.12.2017; c) Skicat e 4 (katër) kateve. Sipas kësaj drejtorie leja e ndërtimit nuk ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie, për të cilën është aplikuar për legalizim. Kjo leje rezulton se ka qenë e falsifikuar e nuk mund të shërbente për ndërtimin e kësaj prone.

4.7 Me pyetësin nr. 2, datë 09.05.2018, Komisioni, ka pyetur subjektin e rivlerësimit të sqarojë në lidhje me truallin në përdorim të banesës me sipërfaqe 215 m², me adresë, lagjia “(***)”, Vlorë, si shumë prej 5,000,000 lekësh, deklaruar në deklarinë e vitit 2003.

Subjekti ka deklaruar: *“Se trualli funksional i kësaj banese ka një sipërfaqe 215 m². Ky truall është pjesë funksionale e banesës, duke përbërë truallin në banesë dhe përreth ndërtesës dhe posedohet në mënyrë të ligjshme, si rrjedhojë e ndërtimit të realizuar mbi këtë truall, e krijuar sipas lejes së ndërtimit, nr. (***) , datë 16.08.1991, të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit. Ky truall është në pronësi shtet dhe posedohet për shkak të ndërtimit të ligjshëm të kryer mbi të”*.

Deklarimi në lidhje me vlerën 5.000.000 lekë, i bërë në momentin e parë të deklarinë nuk është vlerësim i kësaj pasurie, pasi asnjëherë kjo pasuri nuk i është nënshtruar ndonjë vlerësimi nga ZVRPP-ja Vlorë, por në atë periudhë, për efekte të deklarinë të një vlere, përlogaritur si vlerë e përafërt me çmimet, për banesën dhe orenditë, mobilet, pajisjet elektroshtëpiake, elektrike, etj., që kishte banesa. Banesa ka filluar të ndërtohet në vitin 1991 nga bashkëshorti, 12 vjet përpara martesës sonë. Koha e ndërtimit të kësaj banese fillon që nga viti 1991 dhe nuk ka pasur rikonstrukcion thelbësor apo shtesë të sipërfaqes, por meremetime, lysterje dhe punime mirëmbajtjeje janë kryer në vazhdimësi, edhe mbas ndërtimit dhe gjatë viteve, me të ardhurat nga paga apo aktiviteti privat.

4.8 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- Rezulton se ka mungesë dokumentacioni për sa i përket truallit në funksion të ndërtimit, nuk ka ndonjë aktadministrativ për të provuar të drejtën e përdorimit dhe posedimit të truallit me sipërfaqe prej 215 m².
- Nga dokumentacioni i hetimit administrativ rezulton se leja e ndërtimit nuk ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie, për të cilën është aplikuar për legalizim. Kjo leje rezulton se ka qenë e falsifikuar e nuk mund të shërbente për ndërtimin e kësaj prone.
- Rezulton se ka mungesë dokumentacioni provues ligjor për të provuar mënyrën e përfitimit të pronësisë për të gjithë ndërtesën 4-katëshe, sipërfaqen totale të ndërtimit, sipërfaqen për çdo kat, sipërfaqen e truallit në pronësi a përdorim.
- Ka mospërputhje për sa i përket sipërfaqes së truallit dhe kateve të ndërtesës: në deklaratën “Vetting” deklaroni 215 m² truall funksional, në deklarinë periodik të vitit 2003 deklaroni 300 m²; në deklaratën e vitit 2003 deklaroni banesë 3-katëshe, në procesverbalin nga ALUIZNI⁷ rezulton numri i kateve 4 (katër).
- Vlerës se deklaruar: në deklaratën “Vetting” nuk deklarohet vlerë e kësaj banese; në deklaratën e vitit 2003 deklarohet në vlerën 5,000,000 lekë; Duket se nuk është dorëzuar dokumentacion ligjor provues për të provuar mënyrën se si janë shpenzuar 5,000,000 lekë,

⁷ Procesverbali i verifikimit në terren, më datë 19.12.2017, i cili ndodhet tek dosja e ALUIZNI-t Vlorë dërguar nga kjo e fundit.

shpenzimi për gjithë ndërtesën dhe për çdo kat të saj, si dhe vitet kur janë ndërtuar secili kat dhe kur janë bërë rikonstruksionet e fundit të ndërtesës.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi si më poshtë:

4.9 Pasuria e mësipërme figuron e regjistruar në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në masën 100 %, si pasuri e krijuar para martesë. Dokumentacioni për regjistrimin e kësaj prone bazohet në lejen e ndërtimit, nxjerrë sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qytetit Vlorë, nr. (***)/1991, datë 16.08.1991, “Për dhënie leje shesh ndërtimi” (lista shumë emërore) dhe lejen dhe sheshin e ndërtimit të lëshuar në emër të bashkëshortit M. L. Trualli funksional i kësaj banese është pjesë funksionale e saj, duke përbërë truallin nën banesë dhe përreth ndërtesës dhe posedohet në mënyrë të ligjshme, si rrjedhojë e ndërtimit të realizuar mbi këtë truall.

4.10 Leja e ndërtimit, që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie dhe falsiteti i këtij dokumenti, vendimit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qyteti Vlorë, nr. (***), datë 16.08.1991, nuk është komunikuar ndonjëherë as nga prokuroria, as nga Arkivi Shtetëror dhe ZVRPP-ja Vlorë. Nga ana e ZVRPP-së Vlorë është vijuar të lëshohet certifikatë e rregullt për vërtetim pronësie, së paku deri në vitin 2012, kur e ka kërkuar si dokumentacion.

4.11 Falsiteti i lejes së ndërtimit, nxjerrë sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor qyteti Vlorë, nr. (***)/1991, datë 16.08.1991, “Për dhënie leje shesh ndërtimi” (lista shumë emërore), i është bërë me dije bashkëshortit të subjektit, me shkresën nr(***)prot., datë 09.02.2017, Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë, bazuar në kërkesën, që bashkëshorti i subjektit ka paraqitur pranë këtij institucioni, për marrjen e lejes së ndërtimit për këtë objekt, për shkak se ky dokumentacion na nevojitej për deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

4.12 Aplikimi për legalizim është bërë për efekte të legalizimit të marrëdhënieve me truallin si dhe pas vënies në dijeni për faktin që leja e ndërtimit, nr. (***), datë 16.08.1991, ishte shpallur e falsifikuar. Aktualisht, procedimi penal i regjistruar në lidhje me falsitetin e lejes së ndërtimit dhe planimetrisë së sheshit të ndërtimit në emër të shtetasit M. L. është ende në proces hetimi paraprak dhe nuk ka një vendim përfundimtar të organit të akuzës në lidhje me këto dokumente.

4.13 Deklarimi periodik i vitit 2003, për sipërfaqen e truallit 300 m², i referohet gjendjes juridike të sipërfaqes së këtij trualli, sipas dokumentit leje ndërtimi, ku sipërfaqja mbi të cilin do të realizohet ndërtimi është pasqyruar saktësisht, 15m x 20 m, pra 300 m². Që nga ndërtimi i kësaj banese dhe në vijim nuk na është kërkuar apo nevojitur ndonjëherë të kryenim matje të sakta të sipërfaqes së truallit. Saktësimin e sipërfaqes së truallit në posedim e kam realizuar në vitin 2016, për efekte të plotësimit të deklaratës “Vetting” të vitit 2017, duke caktuar një eksperte topografe të licencuar, e cila ka bërë edhe matjet përkatëse dhe ka hartuar planin e rievimit të pronës.

4.14 Deklarata e vitit 2003, në lidhje me numrin e kateve të banesës, i referohet dokumentacionit të rregullt të regjistrimit të pronës pranë ZVRPP-së Vlorë, i cili pasqyron “ndërtesë 3-kate” si dhe gjendjes faktike të pronës. Procesverbali i verifikimit në terren, datë 19.12.2017, i ALUIZNI-t Vlorë, i cili ka pasqyruar 4-kate banesë, mund të ketë konsideruar katër kate, duke numëruar katin e parë jo teknik të ndërtimit, që nuk përdoret si banesë, pasi është bodrum ose pjesën e papafingos. Për sa i përket sipërfaqes së çdo kati, kjo matje nuk është realizuar ndonjëherë nga bashkëshorti im, sepse këtë objekt ne e kemi përdorur për banesë dhe nuk kemi pasur ndonjëherë qëllim shitjen e saj, vërtetimi hipotekor dhe certifikata e pronësisë nuk pasqyron sipërfaqen e çdo kati, por vetëm sipërfaqen totale mbi truall që zë banesa.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën – “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, arsyeton se:

4.15 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit se posedimi i truallit është i ligjshëm, është një deklarinim që bie ndesh me sa ajo është vënë në dijeni nga arkivi i shtetit dhe pas vënies në dijeni të falsitetit të lejes së ndërtimit.

4.16 Referuar nenit 305 të Kodit Civil “*Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm. Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ*”.

Posedimi i truallit nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të subjektit është i paligjshëm pasi nuk ka në bazë një veprim juridik, nuk është bërë në bazë të ligjit ose të një akti administrativ. Shteti është pronari i këtij trualli, poshtë kësaj ndërtese e sikundër u provua nga hetimi administrativ, nuk rezulton që shteti të ketë lëshuar asnjë akt administrativ me anë të të cilit ti jepet e drejta shtetasit M. L., për përdorimin e posedimin e truallit 215 m², (300 m²).

4.17 Leja e ndërtimit e vitit 1991, përcakton sipërfaqen 15m x 20 m, vetëm për ndërtimin e objektit dhe nuk referon asnjë rast përdorim apo posedim të truallit dhe në këto kushte kjo leje nuk mund të shërbejë si argument ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit për të provuar e faktuar pronësinë apo posedimin mbi truallin mbi të cilin është ngritur kjo ndërtesë.

4.18 Komisioni, arsyeton se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se për falsitetin e lejes së ndërtimit, është njoftuar vetëm kur kërkoi lejen në Arkivin Qendror kur i nevojitej për deklaratën “Vetting” të vitit 2017, nuk mund të merret në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë reale të bërjes së kësaj kërkesë dhe sigurimit të dokumentacionit ligjor që në deklarinimin e kësaj pasurie për herë të parë.

4.19 Komisioni, arsyeton se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, se matja e sipërfaqes së çdo kati, nuk është realizuar ndonjëherë sepse ky objekt përdoret për banesë dhe nuk ka pasur ndonjëherë si qëllim shitjen e saj, nuk është në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar sipas ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë në deklaratën “Vetting” me mënyrë të saktë çdo pasuri në pronësi a posedim.

Deklarimi sipas vërtetimit hipotekor pa pasqyruar sipërfaqen e çdo kati, por vetëm sipërfaqen totale mbi truall që zë banesa, është një deklarinim i pasaktë dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr. 84/2016 të subjektit të rivlerësimit.

Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues pronësinë mbi ndërtesë me sipërfaqe 120 m², si dhe truall funksional në përdorim të banesës me sipërfaqe 215 m².
- ii) Nga hetimi ka rezultuar se posedimi i kësaj ndërtese dhe truallit të saj nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të subjektit është i paligjshëm.
- iii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

5. Pasuria, njësi me sipërfaqe 43 m², njësi me sipërfaqe 95 m² dhe garazh me sipërfaqe 35 m², ndodhur në Rr. “(*), Vlorë.**

Faktet nga hetimi administrativ

5.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti ka deklaruar: *B/shorti i subjektit, ka në pronësi, njësi me sip. 43 m², nr. pas (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), Rr. “(***), godina (***),kate, Vlorë.*

Burimi i krijimit: Pronësi e fituar me kontratën e dhurimit, nr. (*** rep., nr. (*** kol., datë 10.02.2016, lidhur me dhuruesin A. L. Vlora: Nuk është vendosur vlora; Pjesa takuese: 100 %.

5.2 *Ka mosdeklarim nga ana e subjektit, në të dy deklaratimet respektive të vitit 2016 dhe asaj “Vetting” të vitit 2017, të vlerës respektive të këtyre pasurive, pavarësisht faktit që ato kanë si burim krijimi kontratë dhurimi.*

5.3 Komisioni i është drejtuar ZVRPP-së Vlorë, me shkresën nr. (*** prot., datë 06.01.2018, në lidhje me pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dhe personit të lidhur më të B/shorti M. L.

5.4 ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. (***)prot., datë 28.02.2018, drejtuar Komisionit ka dërguar informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj dhe personit të lidhur me të b/shortit duke bashkangjitur dhe dokumentacionin respektiv.

5.5 Nga dokumentacioni bashkangjitur ka rezultuar se në lidhje me njësinë me sip. 43 m² dhe njësinë me sip. 95 m² që në total është 138 m² sipas përlllogaritjes së bërë nga ZVRPP-ja Vlorë, në momentin e regjistrimit të asetit në pronësi të shtetasit M. L., vlora e tij është llogaritur në 12,295,800 lekë.

Njësia me sip. 35 m² sipas përlllogaritjes së bërë nga ZVRPP-ja Vlorë, në momentin e regjistrimit të asetit në pronësi të shtetasit M. L., vlora e tij është 1,455,300 lekë.

5.6 Rezulton që këto tre pasuri rrjedhin nga kontratat e mëposhtme:

5.6.1 Kontratë dhurimi, nr. (*** rep., nr. (*** kol., datë 16.10.2015, palë dhuruese “(***”) sh.p.k., me administrator, z. A. L., shoqëria “(***”) sh.p.k., me administrator z. A. Z. dhe shoqëria “(***”) sh.p.k., me administrator znj. F. M. dhe pranues i dhurimit z. A. L.

5.6.2 Kontratë dhurimi, nr. (*** rep., nr. (***)kol., datë 10.02.2016, këto 3 pasuri të përshkruara më sipër me dhurues, z. A. L., i dhurohen z. M. L.

5.7 Komisioni me shkresën nr. (*** prot., datë 23.03.2018, drejtuar ILDKPKI-së ka kërkuar vënie në dispozicion të deklaratave periodike të subjektit deklarues z. A. L.

5.8 ILDKPKI-ja me shkresën nr. (***)prot., datë 27.03.2018, drejtuar Komisionit ka bashkangjitur deklaratat periodike të shtetasit A. L. si subjekt i deklaratimit pranë ILDKPKI-së për shkak të funksionit.

Në analizë të deklaratave periodike të z. A. L. si subjekti deklarimi konstatohet se: ka mosdeklarim në deklaratën periodike të vitit 2015 nga ana e z. A. L. si përfitues i pasurive të paluajtshme, njësi me sip. 43 m² dhe 95 m² dhe një garazh me sip. 35 m², përfituara këto nga kontrata e dhurimit nga shoqëria “(***”) sh.p. k, “(***”) sh.p.k dhe “(***”) sh.p.k.

Ka mosdeklarim në deklaratën periodike të vitit 2016 nga ana e z. A. L. si dhurues i pasuritë e paluajtshme, njësi me sip. 43 m² dhe 95 m² dhe një garazh 35 m² me kontratën e dhurimit, nr.

(***) rep., nr. (***)kol., datë 10.02.2016, vëllait të tij M. L. si person tjetër i lidhur me subjektin.

5.9 Me pyetësonin nr. 2, datë 09.05.2018, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit të sqarojë në lidhje me: a) qëllimin/arsyen e këtij dhurimi; b) burimi i këtij dhurimi; c) përse dhurimi i dytë u bë vetëm 4 muaj pas dhurimit të parë.

5.10 Subjekti në përgjigje të pyetësonit ka deklaruar se:

Midis shoqërive “(***)” sh.p.k., “(***)” sh.p.k dhe “(***)” sh.p.k., ka pasur një kontratë bashkëpunimi dhe bashkëinvestimi për ndërtimin e një objekti shumëkatësh dhe dhurimi i bërë prej tyre në favor të shtetasit A. L. është dhënia në pronësi e pjesës takuese të tij në objektet e shoqërive të tjera, sipas marrëveshjes mes shoqërive.

Dhurimi i kryer është midis dy vëllezërve, për shkak të marrëdhënies së afërt familjare, që kanë me njëri-tjetrin.

Data e kontratës së dhurimit është ajo që pasqyrohet në kontratën përkatëse të dhurimit dhe nuk lidhet me ndonjë afat pas momentit të kalimit në pronësi të këtyre objekteve në favor të shtetasit A.L. Meqenëse, z. A. L., këto objekte nuk i përdorte dhe nuk i shfrytëzonte, ai ia dhuroi vëllait të tij në muajin shkurt 2016 (*subjekti ka bashkangjitur vërtetimin e 3 shoqërive dhuruese*).

5.11 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Hetimi nuk ka nxjerrë në dritë ekzistencën e ndonjë arsyeje substanciale përse janë bërë këto dhurime të konsiderueshme.*
- *Z. A. L., në deklarin periodik të vitit 2016 pranë ILDKPKI-së, si subjekt deklarimi, nuk rezulton të ketë deklaruar dhurimin e pasurive të paluajtshme, njësi me sip. 43 m² dhe 95 m² dhe një garazh me sip. 35 m² për vëllain e tij/bashkëshortin e subjektit, z. M. L.*
- *Rezulton se ka mungesë dokumentacioni provues për burimin e krijimit të këtyre pasurive nga personi tjetër i lidhur, z. A. L.*

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi si më poshtë:

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ Komisioni arsyeton se **kontrata e dhurimit është fiktive, me qëllim fshehjen e burimeve reale të përdorura për arsyet e mëposhtme:**

5.12 Subjekti nuk ka paraqitur kontratën e investimit dhe bashkëpunimit të tre shoqërive siç deklarohet në vërtetimin e lëshuar prej tyre për të provuar me dokumentacion ligjor mënyrën e fitimit të kësaj pasurie.

5.13 Nuk është paraqitur asnjë dokumentacion ligjor për miratimin nga asambleja e përgjithshme e shoqërive dhe pasqyrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së këtyre shoqërive për këto dhurime sipas parashikimeve në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në nenin 81 “Të drejtat dhe detyrimet”.

5.14 Mosdeklarimi në deklaratën periodike të vitit 2015 nga, z. A. L., i përfitimit të këtyre pasurive të paluajtshme: njësi me sip. 43 m² dhe 95 m² dhe një garazh me sip. 35 m² si dhe mosdeklarim në deklaratën periodike të vitit 2016 nga z. A. L. i dhurimit të pasurive të paluajtshme, njësi me sip. 43 m² dhe 95 m² dhe një garazh me sip. 35 m² me kontratën e dhurimit, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 10.02.2016, vëllait të tij z. M.L.

5.15 Z. A.L., ka përfituar vetëm tre objekte me anë të dhurimit, të cilat më pas ia ka dhuruar shtetasit M. L., fakt i cili krijon bindjen se kontrata e dhurimit është fiktive, me qëllim fshehjen e burimeve reale të përdorura për vlerën totale të aseteve të dhuruara në vlerën rreth 13.751.100 lekë.

5.16 Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacioni ligjor provues, për vendimin e ortakëve të shoqërive, si dhe bilancet e këtyre shoqërive, ku të evidentohet veprimi i kryer lidhur me dhurimin e bërë shtetasit A. L.

Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me dhurimin e bërë nga ana e shtetasit A. L., kundrejt shtetasit M. L., për pasuritë garazh me sip. 35 m², njësi me sip. 43 m², njësi me sip. 95 m².
- ii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij.
- iii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

6. Pronësia, automjetet në pronësi apo përdorim si dhe ato të tjetërsuara nga subjekti apo personat e lidhur me të.

6.1 Automjeti, tip “Benz 140”, viti i prodhimit 1993, me targa (*)**

Faktet nga hetimi administrativ

6.1.1 Në deklaratën e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pronësi të B/shorti, automjet, tip “Benz 140”, viti i prodhimit 1993, vlera 50,000 lekë, me targa (***). Burimi: Të ardhura nga aktiviteti privat. Vlera: 0.5 milion lekë ose 50,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

6.1.2 Në deklaratën e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shitje e automjetit me targë, (***) (më parë (***)), shtetasit N. H., sipas kontratës së shitblerjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 28.05.2013, notere L. C. Vlera: 15,000 euro. Pjesë takuese: 50 %.

6.1.3. Komisioni me shkresën nr. (***)prot , datë 23.03.2018, i është drejtuar DPSHTRR-së në lidhje me dosjen e mjetit, me targë (***) , që më pas është ndërruar me targa (***) .

6.1.4 DPSHTRR-ja me shkresën nr. (***)prot , datë 18.04.2018, i ka dërguar Komisionit dosjen e mjetit, me targë (***) , ndryshuar në targa (***) .

6.1.5 Referuar dokumentacionit në dosje rezulton kontrata e shitblerjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.10.2002, me shitës A. G. dhe blerës M. L. për blerjen e mjetit, tip “Mercedes Benz”, nr. shasie (***) , ngjyrë gri, viti prodhimit 1993, targa (***) . Me çmim 500,000 lekë. Çmimi i likuiduar prej palës blerëse jashtë kësaj zyre noteriale.

6.1.6 Komisioni, me shkresën nr. (***)prot., datë 23.03.2018, i është drejtuar notere L. C. ku ka kërkuar të vërë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar duke iu referuar të dhënave të marra nga regjistri noterial.

6.1.7 Notere L. C., me shkresën nr. Ekstra rep., datë 29.03.2018, ka dërguar kontratë shitje automjeti, nr. (***) rep. , nr. (***) kol., datë 28.05.2013, me palë shitës M. L. dhe blerës N. H., për mjetin tip, “Mercedes Benz” 140, vlera 300 USD, nr. shasie (***), naftë, targa (***), 4+1, ngjyrë gri, viti prodhimit 1993. Çmimi i shitblerjes 15,000 euro, likuiduar 100 %, jashtë zyrës noteriale.

6.1.8 Komisioni, më datë 09.05.2018, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit pyetësorin nr. 2, ku një nga pyetjet ishte: Si është e mundur që mjeti tip “Mercedes Benz”, me vit prodhimi 1993, blerë në vitin 2002, me çmim 500,000 lekë është shitur në vitin 2013 me çmim 15,000 euro duke pasur parasysh normën e amortizimit dhe vitet e përdorimit?

6.1.9 Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, është përgjigjur se në momentin e blerjes, këto automjete janë blerë me çmim të ulët dhe të favorshëm, për shkak se janë blerë në gjendje jo të mirë teknike dhe kanë pasur nevojë për shërbime. Pas blerjes së tyre, nga ana e blerësit M. L. iu janë bërë shërbime të nevojshme, lyerje etj., dhe nuk janë përdorur, pra nuk kanë pasur normë amortizimi, për shkak se bashkëshorti i subjektit ka pasur automjet tjetër. Në kushtet e mungesës së çmimeve të referencës apo çmimeve tavan për automjetet si dhe bazuar në faktin se shitblerjet janë bërë mes personave fizikë, këto çmime përbëjnë çmime të rëna dakord me marrëveshje mes palëve, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë.

6.1.10 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Automjeti “Benz 140”, viti i prodhimit 1993, blerë në vitin 2003, me vlerë 50,000 lekë dhe shitur në vitin 2013 në vlerën 15,000 euro.*
- *Mospërputhje për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit “Benz” 140 (300USD).*
- *Në deklaratën e vitit 2003, subjekti deklaroi se çmimi i blerjes është 0.5 milion lekë, ndërsa në kontratën e shitjes, më datë 17.10.2002, çmimi i blerjes rezultoi 500,000 lekë.*
- *Duket se shitja e mjetit është bërë me çmim fiktiv, pasi:*
 - *mjeti ka vit prodhimi 20 vjet përpara;*
 - *shitet 10 vjet pasi është blerë, me kosto shumë herë më të lartë;*
 - *likuidim i çmimit të shitjes, i pashoqëruar me asnjë dokument provues.*

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi të njëjtën argument si në përgjigje të pyetësorit.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arsyeton se:

6.1.11 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se automjeti tip “Mercedes-Benz” (140), i vitit 1993 (blerë 500,000 lekë dhe shitur 15,000 euro), nga bashkëshorti i subjektit pasi ky automjet është blerë me çmim shumë të ulët sepse janë blerë në gjendje jo të mirë teknike, i janë bërë shërbimet e nevojshme, lyerje etj., dhe nuk janë përdorur dhe për këtë arsye nuk ka

pasur normë amortizimi, nuk është bindës pasi amortizimi i automjeteve është një proces që ndodh aq më tepër kur makinat nuk përdoren për një kohë të gjatë.

6.1.12 Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor shpenzimet që ka bërë për këtë mjet të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij me rreth 4 herë më shumë se çmimi i blerjes pas 11 vitesh nga viti i blerjes dhe pas 20 vitesh nga viti i prodhimit të këtij automjeti.

Komisioni, arrin në përfundimin se shitja e autoveturës, tip “Mercedes Benz” (140) i vitit 1993, me çmim 4 herë më shumë se ai i blerjes nga ana shitësit, në të vërtetë përbën një veprim financiar të pajustificuar.

6.2 AUTOVETURË, TIP “BENZ - MERCEDES”, ME TARGA (*)**

Faktet nga hetimi administrativ

6.2.1 Në deklaratën periodike të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pronësi të “B/shortit të subjektit, blerë autoveturë tip “Benz - Mercedes”, me targa (***) , nr. shasje (***) , kontratë shitje, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 10.08.2009. Burimi i krijimit: Nuk është përmendur. Vlera: 600,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

6.2.2. Në deklaratën periodike të vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pasuri të B/shortit të subjektit, shitje autoveturë, tip “Benz - Mercedes”, nr. shasje (***) , me targa (***) , kontratë shitje, nr. (***) rep. , nr. (***) kol., datë 17.08.2010. Vlera: 20,000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

6.2.3 Komisioni, me shkresën nr. (***) prot., datë 23.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së ka kërkuar dosjen e plotë të këtij mjeti.

6.2.3.1 Në dosjen e dërguar nga DPSHTRR-ja, një dokument (*e-mail*) ku DPSHTRR-ja ia dërgon Drejtorisë Rajonale Vlorë, ku informon se mjeti me numër shasje (***) , me targë (***) , rezulton i vjedhur (*dhe jo e rregullt*).

6.2.3.2 Në dosjen e dërguar nga DPSHTRR-ja për këtë shitje rezulton kontratë noteriale me nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 20.06.2010⁸, “Shitblerje automjeti”, përpara notere Sh. Gj., me palë shitëse M. L. dhe blerës K. S., me çmim 20,000 euro.

Kjo kontratë është e ndryshme nga kontrata tek dosja e ILDKPKI-së depozituar nga vetë subjekti, me nr. (***)rep., nr. (***)kol., datë 17.08.2010⁹, “Shitblerje automjeti”, përpara notere L. C., me palë shitëse M. L. dhe blerës K.S.

Subjekti i rivlerësimit në deklarinimin periodik vjetor 2012, ka deklaruar se ka marrë hua në shumën 30.000 euro, me huadhënës shtetasin K. M.S., e cila është përdorur për likuidimin e huas në shumën e mbetur 44.000 euro, përmendur më sipër. Kalimi i shumës nga huadhënësi tek huamarrësi si dhe shlyerjet e bëra rezultojnë se nuk janë kryer nëpërmjet sistemit bankar por *cash*, fakt i cili ngre dyshimin mbi vërtetësinë e tyre

Referuar deklarinimit periodik vjetor 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, “*shtuar gjendja cash në shumën 15.000 euro nga shitja e autoveturës në shumën 15.000 euro*”. Gjendja *cash* e krijuar u përdor për shlyerjen e një pjesë së huas (*huaja e marrë në shumën totale 30.000 euro*) në vitet 2013 dhe 2016.

⁸ Kontrata, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.06.2010, me palë shitës M.L. dhe blerës K.S. ndodhet në dosjen e DPSHTRR-së.

⁹ Kontrata, nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 17.08.2010, me palë shitës M.L. dhe blerës K.S. ndodhet në dosjen e ILDKPKI-së depozituar nga vetë subjekti.

6.2.4 Komisioni, më datë 09.05.2018, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit pyetësonin nr. 2, ku një nga pyetjet ishte: Si është e mundur që automjeti, tip “Mercedes Benz” blerë në vitin 2009 me çmim 600,000 lekë është shitur në vitin 2010 me çmim 20,000 euro?

6.2.5 Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se në momentin e blerjes, këto automjete janë blerë me çmim të ulët dhe të favorshëm, për shkak se janë blerë në gjendje jo të mirë teknike dhe kanë pasur nevojë për shërbime. Pas blerjes së tyre, nga ana e blerësit M. L. iu janë bërë shërbime të nevojshme, lyerje etj dhe nuk janë përdorur, pra nuk kanë pasur normë amortizimi, për shkak se bashkëshorti im ka pasur automjet tjetër.

Në kushtet e mungesës së çmimeve të referencës apo çmimeve tavan për automjetet si dhe bazuar në faktin se shitblerjet janë bërë mes personave fizikë, këto çmime përbëjnë çmime të rëna dakord me marrëveshje mes palëve, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë

6.2.6 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

- *Automjeti “Mercedes-Benz” me targa (***), deklaruar i blerë në vitin 2009 me vlerë 600,000 lekë dhe shitur në vitin 2010 në vlerën 20,000 euro.*
- *Nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, pasi ky mjet, referuar kartelës së mjetit të datës 23.04.2007, rezulton që në këtë vit në pronësi të z. G. Sh. dhe z. M. L.*

Duket se blerja dhe shitja e mjetit është bërë fiktivisht, pasi:

- *Referuar kartelës së mjetit të datës 23.04.2007, rezulton në pronësi të G. Sh. dhe M. L.;*
 - *Taksa doganore për këtë mjet, në shumën 784,783 lekë, është më e madhe se çmimi i shitjes së tij (sipas pagesës së taksës doganore, vlera e makinës është përafërsisht 3.5 milionë lekë të rinj);*
 - *Cili ka qenë qëllimi i hartimit të një kontratë shitjeje ndërmjet dy pronarëve të një mjeti, aq më tepër me një vlerë më të vogël se vetë taksa doganore;*
 - *Likuidim i çmimit të blerjes dhe të shitjes, i pashoqëruar me asnjë dokument provues;*
 - *Shitja e këtij mjeti është bërë me një çmim 5 (pesë) herë më të shtrenjtë se çmimi i blerjes, ose rreth 15,000 euro më shumë;*
 - *Deklarimi juaj se janë blerë lirë, pasi kanë qenë në gjendje të dobët teknike dhe se janë bërë riparime dhe shërbime, nuk provohet me dokumentacion justifikues;*
 - *Për këtë automjet rezultuan dy kontrata noteriale shitjeje në periudha të ndryshme.*
- ✓ *Kontrata nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.06.2010¹⁰, “Shitblerje automjeti”, përpara noteres Sh. Gj., me palë shitëse M. L. dhe blerës K. S., me çmim 20,000 euro (kontrata te dosja e DPSHTRR-së);*
 - ✓ *Kontrata nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.08.2010¹¹, “Shitblerjeje automjeti” përpara noteres L. C., me palë shitëse M. L. dhe blerës K. S. (kontrata te dosja e ILDKPKI-së).*

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi të njëjtën argument si në përgjigje të pyetësorit si dhe deklaroi se nuk është në dijeni të dy kontratave për këtë mjet.

Arsyetimi ligjor

¹⁰ Kontrata, nr. (***)rep., nr. (***)kol., datë 20.06.2010, me palë shitës M. L. dhe blerës K. S. ndodhet në dosjen e DPSHTRR-së.

¹¹ Kontrata, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.08.2010, me palë shitës M. L. dhe blerës K. S. ndodhet në dosjen e ILDKPKI-së depozituar nga vetë subjekti.

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arsyeton se:

6.2.7 Veprimi juridik i blerjes së pasurisë rezulton të jetë jo real pasi në deklaratën periodike të vitit 2007 ky mjet nga ana e subjektit apo dhe b/shortit të subjektit, megjithëse sipas kartelës së mjetit, më datë 23.04.2007, ku ky mjet rezulton pronësi të z. G. Sh. dhe z. M. L. dhe pas dy vjetësh formalizon këtë pronësi të mjetit me kontratë tek noteri.

6.2.8 Çmimi i shitjes është joreal pasi vlera 600,000 lekë deklaruar si çmim shitje nga shitësi G. Sh. tek blerësi M. L., është më e vogël se sa shuma që shtetasi G. Sh. ka paguar vetëm për taksë doganore për këtë mjet në vlerën 784,783 lekë.

6.2.9 Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor shpenzimet që ka bërë për këtë mjet, shpenzime të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës e tij me rreth 4.5 herë më shumë se çmimi i blerjes ose rreth 15,000 euro më shumë.

6.2.10 Komisioni, arsyeton se deklarimi i subjektit në pyetësin nr. 2, dhe në përgjigje të barrës së provës se blerja e këtij automjeti në përdorim me çmim të lirë dhe shitja më pas e tij 5-fishin me justifikimin se është blerë lirë pasi kanë qenë në gjendje të dobët teknike dhe se janë bërë riparime dhe shërbime, nuk provohet me dokumentacion justifikues shërbimet dhe rregullimet e bëra që supozohet që i kanë rritur vlerën.

6.2.11 Deklarimi i subjektit për sa referon mungesën e çmimit të referencës, në kushtet e tregut të lirë, referuar kontratave të shitblerjes së mjeteve ku likuidimi i çmimit të këtyre shitjeve është bërë jashtë zyrës noteriale, nuk janë arsye që justifikojnë veprimet fiktive të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

6.2.12 Komisioni, arsyeton se blerja dhe shitja e këtij mjeti janë veprime fiktive nga subjekti i rivlerësimit pasi:

6.2.12.1 Sipas kartelës së mjetit, më datë 23.04.2007, ku ky mjet rezulton në bashkëpronësi të z. G. Sh. dhe z. M. L., fakt ky që nuk referohet në blerjen e këtij mjeti.

6.2.12.2 Për këtë shitje rezultojnë dy kontrata noteriale shitje në periudha të ndryshme. Kontrata me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.06.2010¹², “Shitblerje automjeti”, përpara notere Sh. Gj., me palë shitëse M. L. dhe blerës K. S., me çmim 20,000 euro (*kontrata tek dosja e DPSHTRR-së*) dhe nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.08.2010¹³, “Shitblerje automjeti”, përpara notere L.C., me palë shitëse M. L. dhe blerës K. S. (*kontrata te dosja e ILDKPKI-së depozituar nga vetë subjekti*). Pra i njëjti mjet rezulton i shitur dy herë në një diferencë prej 2 muajsh shitjes nga njëra-tjera që na bën të dyshojmë se flitet për qarkullim të 40,000 euro dhe jo 20,000 euro.

6.2.12.3 Rezulton se për një periudhë 1-vjeçare vlera e automjetit është rritur 4.5 herë. Veprimi fiktiv është kryer nga ana e subjektit të rivlerësimit me qëllim që shuma e përfituar nga shitja e autoveturës të përdorej për shlyerjen e një pjesë të huas të marrë në shumën totale 30.000 euro nga shtetasi K.S. Nuk ka deklarim të bashkëpronësisë së këtij mjeti. Shtetasi M. L. e ka pasur që në vitin 2007, gjë që nuk rezulton e deklaruar në deklaratën e atij viti.

¹² Kontrata, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.06.2010, me palë shitës M. L. dhe blerës K. S. ndodhet në dosjen e DPSHTRR-së.

¹³ Kontrata, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.08.2010, me palë shitës M. L. dhe blerës K. S. ndodhet në dosjen e ILDKPKI-së depozituar nga vetë subjekti.

Komisioni arrin në përfundimin se shitja e autoveturës, tip “Mercedes Benz”, i vitit 2000, me çmim 4 herë më shumë se ai i blerjes nga ana shitësit, në të vërtetë përbën një veprim financiar të pajustificuar, ndërsa ekzistenca e dy kontratave të shitjes për të njëjtin automjet me të njëjtin çmim për Komisionin përbën një veprim fiktiv me qëllim për të mbuluar shlyerjen e huas.

6.3 Automjeti, tip “Mercedes-Benz”, me targa (***) , deklaruar dhuruar vëllait të tij A. L. në vitin 2015. Dhuruesi, z. M. L., ka deklaruar në kontratën e dhurimit: “Vlera e autoveturës që dhurohet është 1,000,000 lekë.”.

Mjeti i mësipërm, me të gjitha parametrat e përmendur në kontratë, varion me çmim blerjeje nga 22,200 euro deri në 27,500 euro, pa përfshirë këtu vlerën e taksës doganore.

Faktet nga hetimi administrativ

6.3.1 Në deklaratën e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: Blerë mjeti, tip “Volswagen”, me targa (***) , me kontratë, nr(***)rep., nr. (***) kol., datë 24.06.2010. Burimi i krijimit: Kursime nga paga. Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

6.3.2 Në deklaratën e vitit 2014 subjekti ka deklaruar: Shitje automjeti, me targa (***) , shtetasit L. C., sipas kontratës, datë 02.05.2014. Vlera: 3,000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

6.3.3 Komisioni, me shkresën nr. (***) prot., datë 23.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së ka kërkuar informacion dhe dosjen e plotë për mjetin, tip “Volswagen”, me targë (***) .

6.3.4 Sipas kontratë shitje automjeti, nr. (***) rep. , nr. (***) kol., datë 02.05.2014¹⁴, me palë shitëse Alma Liçaj dhe blerës L. C., për mjetin me targa (***) , tip “Volswagen”, me nr. shasje (***) , benzinë, ngjyrë gri, viti i prodhimit 2002. Çmimi i shitjes 3,000 euro, likuiduar 100 % jashtë zyrës noteriale.

6.3.5 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektivit të rivlerësimit për sa më poshtë:

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektivit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arsyeton se:

6.3.6 Shpjegimi i subjektivit të rivlerësimit se ky automjet është blerë me çmim shumë të ulët sepse është blerë në gjendje jo të mirë teknike, i janë bërë shërbimet e nevojshme, lysterje etj dhe nuk janë përdorur dhe për këtë arsye nuk ka pasur normë amortizimi, nuk është bindës pasi amortizimi i automjeteve është një proces që ndodh aq me tepër kur makinat nuk përdoren për një kohë të gjatë.

6.3.7 Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor shpenzimet që ka bërë për këtë mjet të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij me rreth 4 herë më shumë se çmimi i blerjes pas 11 vitesh nga viti i blerjes dhe pas 20 vitesh nga viti i prodhimit të këtij automjeti.

¹⁴ Kontrata, nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 02.05.2014, me palë shitëse Alma Liçaj dhe blerës L. C. ndodhet në dosjen e DPSHTRR-së.

6.3.8 Komisioni arrin në përfundimin se shitja e autoveturës me çmim 3 herë më shumë se çmimi i blerjes në të vërtetë përbën veprim financiar të pajustificuar.

Në vlerësim tërësor të procedurave për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit, znj Alma Liçaj, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive të simuluar, të cilat nuk përputhen me sjelljet që një gjyqtare pritet të ketë, dhe duke cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

Jeta personale e gjyqtarëve, sjellja e tyre jashtëgjyqësore, është po aq e rëndësishme sa ajo në kontekstin profesional. Standarde të sjelljes së gjyqtarëve janë shtjelluar shterueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Siç shtjellon jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me paanësinë, në “Teorinë e dukjes”, edhe jashtë gjykatës dhe përfshijnë jetën private, duke kërkuar që gjyqtarët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën.

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës ndaj saj zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës .
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë në përputhje me paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin ndaj publikut në përputhje me paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 58, pika 1/ c dhe nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë e publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 15.11.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues
Lulzim HAMITAJ

Anëtar
Olsi KOMICI

Relatore
Xhensila PINE

Sekretare gjyqësore:
Denisa Kosta